



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY  
 Nr. Dep. DPKI  
 Nr. Prot. 06-02/266/22  
 Data 24.06.2022  
 Datum Date  
 PRISHTINE

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nëparag. 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nëparag. 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 24.06.2022, nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

- I. Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-2597/21, për zyrtarin e lartë z. Fitim Uka, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik.**
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Fitim Uka, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi është identifikuar se z. Fitim Uka, krahas ushtrimit të funksionit publik Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, është edhe përfaqësues i autorizuar në bizneset private "Fitim Uka" B. I. (Empatia) dhe "Pathway" SH.P.K, si dhe ka funksion drejtues në OJQ "Kosovo Association for Family Therapy". Ushtrimi i këtyre detyrave, krahas ushtrimit të funksionit publik, është i ndaluar me dispozitat e LPKI-së.

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit, me qëllim të verifikimit të gjendjes së papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, ka kërkuar informatat për bizneset dhe OJQ-në në fjalë, nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) dhe nga Departamenti për OJQ në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Nga informatat për bizneset të cilat Agjencia kundër Korrupsionit e ka pranuar prej ARBK-së (shkresa zyrtare: DPKI-06-2597/21), është konstatuar se zyrtari i lartë z. Fitim Uka, figuron si person i autorizuar në bizneset e sipërhënuara. Ndërsa nga përgjigja e pranuar prej Departamentit për OJQ (shkresa zyrtare: DPKI-06-2609/21), zyrtari në fjalë figuron të jetë përfaqësues i autorizuar - zëvendës drejtor i OJQ-së si më lart.

Agjencia kundër Korrupsionit, me shkresën zyrtare DPKI-06-02/2168/22, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj z. Fitim Uka është njoftuar lidhur me faktet për rastin e tij, si dhe është udhëzuar për veprimet që



duhet t'i ndërmerr për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë përfaqësues i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohe me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të LPKI-së, ku përcaktohet se:

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.*

Përveç kësaj, zyrtari i lartë nuk mundet që, njëkohësisht me ushtrimin e funksionit publik, të mbajë funksion drejtues në OJQ, sepse kjo situatë është në kundërshtim me nenin 14 paragrafi 1, të LPKI-së, i cili përcakton se:

*“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të tjera të lidhura me to”.*

Zyrtari i lartë z. Fitim Uka, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka premtuar se menjëherë do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar informatën të cilën më pas e ka konfirmuar nga ARBK (DPKI-06-02/2168-02/22) dhe nga Departamenti për OJQ në Ministrinë e Punëve të Brendshme (DPKI-06-02/2168-01/22), se zyrtari i lartë ka bërë ndryshimet e nevojshme në biznese, duke bartur të drejtat e drejtimit të biznesit tek një person tjetër (personi i besuar), si dhe ndryshimet e nevojshme në OJQ.

Pas analizimit të informatave si më lartë, Agjencia kundër Korrupsionit konstatoi se zyrtari i lartë z. Fitim Uka, ka transferuar të drejtat e drejtimit të biznesit privat tek personi i besuar, si dhe është tërhequr nga funksioni në OJQ, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 15, si dhe nënparagrafi 1.3, të LPKI-së. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshkaj  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

